



PROJEKTI “SHKOLLA QËNDER KOMUNITARE”

Nis me shfrytëzimin e ambienteve sportive të Shkollave 9-Vjeçare e të Mesme të qytetit të Durrësit nga Federatat Sportive/Shoqatat sportive/Klubet sportive, për edukimin dhe masivizimin e shumë sportit në Durrës.

QËLLIMI PROJEKTIT

Nxitja e bashkëpunimit ndërmjet Federatave Sportive/Shoqatave sportive/Klubeve sportive dhe Bashkisë së Durrësit duke krijuar një skemë efektive me qëllim përmirësimin e jetës dhe shëndetit të komunitetit dhe shfrytëzimin e palestrave dhe ambienteve sportive pranë shkollave 9-vjeçare dhe të mesme publike. Projekti konsiston në dhënien në përdorim kundrejt tarifës 200 lekë/ora, miratuar me VKB 89 datë 26.07.2021.

OBJEKTIVAT SPECIFIKE

Promovimi dhe implementimi i sporteve si një mundësi edukimi fizik dhe argëtimi për fëmijët e shkollave të ciklit 9-vjeçar dhe atij të mesëm;

1. Ndihmesën në zhvillimin e shëndetit, zhvillimin e cilësive fizike, shprehive motorike e koordinative si dhe në vlerat shoqërore të fëmijëve duke ushtruar një sport
2. Formimin e fëmijëve në aspektin fizik dhe mendor, si mjet për të luftuar sedentarizmin dhe për të shmangur çdo formë të shfaqjeve negative të kohës, obezitetin dhe zhvillimin e miqësive ndërmjet nxënësve duke u përfshirë në aktivitete sportive;
3. Mundësimi i përfshirjeve dhe realizimit të garave sportive në dobi të shëndetit dhe zhvillimit të aftësive motorike dhe në shërbim të rritjes së cilësisë;
4. Evidentimi i rolit të mësuesit (trajnerit), si ekspert dhe edukator i rëndësishëm për fëmijët;
5. Rritja e interesit të fëmijëve ndaj sporteve;

6. Federatat Sportive/Shoqatat sportive/Klubet sportive duhet të mbështesin integrimin në aktivitete sportive pa pagesë të fëmijëve dhe të rinjve të cilët vijnë nga grupe sociale vulnerabël (fëmijët nga familje në nevojë, jetime, femije me një prind, ndihmë ekonomike.);
7. Federatat Sportive/Shoqatat sportive/Klubet sportive angazhohen që dy ditë në javë të ofrojnë aktivitete sportive pa pagesë në shërbim të komunitetit;
8. Krijimi i traditës ndaj sporteve dhe përmirësimi i infrastrukturës së nevojshme për këtë qëllim;

APLIKANTET E PRANUESHEM

Federatat Sportive/Shoqatat sportive/Klubet sportive aplikojnë pranë Bashkisë së Durrësit me anë një Formular Aplikimi ku shprehin interesin e tyre për të ushtruar aktivitetin e tyre, në sportin specifik, në palestrën e shkollës ose ambienteve sportive, pas orëve të mësimin. Formularin e aplikimit mund ta shkarkoni nga faqja jonë zyrtare në adresën: durrës.gov.al

PROÇESI APLIKIMIT

Bashkia shpallë thirrje për aplikim për projektin "Shkollë Qëndër Komunitare" nëpërmjet formularit të aplikimit që mund ta shkarkoni në faqen zyrtare të Bashkisë Durrës ose në sportelet e marrdhënieve me publikun.

HAPJA E APLIKIMEVE

Bashkia e Durrësit hap aplikimet për projektin duke plotësuar formularin e aplikimit. Aplikimet do të dorëzohen në zyrën e marrdhënieve me Publikun në Bashkinë Durrës deri me 30 Korrik.



APLIKIM PËR PROJEKT

“SHKOLLA QËNDËR KOMUNITARE”

A. Informacion mbi Federatën Sportive/ Shoqatën sportive/Klubin sportiv, persona fizik ose Juridik:

1. Emri dhe Mbiemri i aplikuesit _____
2. Numri Telefonit _____
3. E-mail i aplikuesit _____
4. Adresa _____

B. Jepni një përshkrim të përgjithshëm të projektit (ose bashkëlidhur projektin)

C. Ju lutem parashtoni kalendarin me datat dhe oraret të cilët do të zhvilloni aktivitetin:

(kalendarin duhet t'programohet vetëm pas orarit mësimor dhe për ditët e pushimit)

D. Dokumentacioni bashkëlidhur:

1. Nipt ose Vendim Gjyqsor
2. Statute
3. Akt themelimi
4. Liçensë nga federate përkatëse për sportin
5. Kopje të kartës së ID

(dokumentacioni i kërkuar duhet të jenë të noterizuar, nëse aplikuesi është person fizik me NIPT duhet të paraqes vërtetimin nga federate përkatëse e sportit).

DEKLARATË

Unë në cilësinë e aplikantit dhe njëkohësisht të drejtuesit të Projektit të paraqitur, deklaroj se të gjitha materialet dhe dokumentacionet e sipërshkruar dhe të bashkëngjitur janë të vërteta, pranoj të gjithë kushtet e projektit.

FIRMË

DATE
